B4STUDENTS

2021

BUSINESS CHALLENGE COMPETITION

Një sfidë biznesi për studentët më mendjemprehtë

PËRMBAJTJA

03 Rreth B4Students
04 Rreth Business Challenge Competition
05 Prezantimi i Sfidës së Biznesit
07 Letër nga CEO
08 Green Coast

RRETH **B4STUDENTS**

B4STUDENTS

B4Students është program i dedikuar për studentët në Shqipëri me fokus zhvillimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin e tyre, me mbështetjen e Grupit BALFIN.

Programi është i ndërtuar në 4 komponentë kryesorë:

SIPËRMARRJE

organizimi i Konkursit të Ideve të Biznesit, si dhe i Sfidave të Biznesit

KLUBET SOCIALE

mbështetja e propozimeve për projekte sociale që kanë impakt pozitiv në komunitet

PRAKTIKA PROFESIONALE

krijimi i mundësive për zhvillimin e praktikës profesionale në shoqëritë e Grupit

FUQIZIMI I UNIVERSITETEVE

vlerësimi i nevojave të Universiteteve Publike për investime infrastukturore

Programi u prezantua për publikun në muajin maj 2021. Regjistrimi i studentëve në program është i mundur në çdo moment përmes plotësimit të formularit online në:

bit.ly/iamb4students

Gjatë rrugëtimit të tij, programi B4Students do të ketë edhe bashkëpunëtorë të çmuar si Institucionet e Arsimit të Lartë, shoqëritë e Grupit BALFIN, si dhe partnerë ndërkombëtarë.

RRETH **BUSINESS CHALLENGE COMPETITION**

Një mundësi për të zgjidhur një sfidë reale biznesi.

Konkursi i Sfidave të Biznesit, organizuar nga programi B4Students në bashkëpunim me kompani partnere, është një aktivitet i dedikuar për studentët të cilët konkurrojnë për të krijuar e prezantuar zgjidhjen më të mirë për një sfidë reale biznesi.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është të nxisë dhe mbështesë rritjen profesionale të studentëve në Shqipëri të cilët duan të testojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në analizën e problemeve të biznesit dhe menaxhimin strategjik, në rrethana konkrete.

KRITERET E PJESËMARRJES

- vijimi i studimeve të larta
- pjesëmarrje individuale

LINKU I REGJISTRIMIT

bit.ly/bcc-apply-now

DËRGIMI I ZGJIDHJES

hello@b4students.com

DATA TË RËNDËSISHME

25 tetor 2021
afati i regjistrimit online

28 tetor 2021
dërgimi i zgjidhjes

29 tetor 2021
përzgjedhja e finalistëve

03 nëntor 2021
prezantimi përpara jurisë dhe shpallja e fituesve

Në formulimin e zgjidhjes inkurajohet të jeni krijues. Kujdes! Një strategji konkurruese duhet të jetë në përputhje me natyrën e biznesit dhe të balancojë vlefshmërinë financiare me përgjegjësinë e qëndrueshmërinë.

KRITERET E VLERËSIMIT

- Kreativiteti i zgjidhjes
- Dobishmëria e zgjidhjes
- Zbatueshmëria e zgjidhjes
- Detajimi i zgjidhjes

ÇMIMET PËR FITUESIT

Shpërblim monetar (sipas renditjes: 1 - 250 €; 2 - 200 €; 3 - 150 €)

Kurs trajnimi me përzgjedhje nga studenti (në LinkedIn Learning)

Ofertë për praktikë profesionale me mundësi punësimi

SFIDA E BIZNESIT

Për sfidën e biznesit të vitit 2021 është përzgjedhur shoqëria Green Coast Resort and Residences, në menaxhimin e Balfin Real Estate & Hospitality.

Interesi në rritje i njerëzve për të shijuar momente në Green Coast Resort and Residences është një fakt inkurajues. Por, Green Coast mund dhe do të bëjë edhe më shumë, për t'u konsideruar një destinacion i preferuar 365 ditët e vitit.

Ndaj, B4Students ju kërkon t'i përgjigjeni sfidës kryesore:

Si mund të përmirësojmë jetëzimin e Green Coast përgjatë gjithë vitit?

Studenti, sipas preferencës, mund të trajtojë një a disa nga nënsfidat e mëposhtme:

1. Cilat janë investimet, nismat dhe shërbimet e reja që duhet të mundësohen nga Green Coast për banorët dhe vizitorët, aktualë dhe të rinj, për të garantuar një aktivitet të qëndrueshëm gjatë 365 ditëve të vitit?
2. Cilat do të ishin aktivitetet artistike, kulturore dhe/ose sportive që duhet të mundësohen nga Green Coast, për të garantuar opsione alternative të menaxhimit të kohës së qëndrimit dhe argëtimit, për një jetesë sa më aktive?
3. Cila do të ishte zgjidhja më e mirë ekologjike dhe teknologjike për të mundësuar lëvizshmërinë e stafit, banorëve dhe vizitorëve brenda hapësirës së Green Coast, në mënyrë sa më të organizuar, eficente dhe praktike?
4. Cilat do të ishin disa mënyra për ruajtjen dhe zvogëlimin e ndikimit në mjedis nga Green Coast, me investime të reja për eficensën energjitike dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në harmoni me zonën e Palasës?
5. Cila do të ishte mënyra më e mirë e trajtimit të mbetjeve në Green Coast, që mundëson reduktimin cilësor të mbetjeve, ripërdorimin e materialeve të dobishme dhe riciklimin e tyre, me kosto sa më efektive?

LETËR NGA CEO

Të nderuar studentë,

Jam shumë e lumtur të njoftoj se **Green Coast Resort and Residences**, një ndër historitë më të mëdha të suksesit në portofolin e Balfin Real Estate & Hospitality, është përzgjedhur për Konkursin e Sfidave të Biznesit 2021 nga B4Students.

Ajo ç'ka duam për Green Coast është zhvillimi i saj si një destinacion i ri në hartën e destinacioneve turistike më mikluese dhe atraktive në nivel ndërkombëtar.

Ne jemi 100% të fokusuar të ofrojmë një eksperiencë të përkryer për t'u shijuar 365 ditët e vitit. Të ofrojmë shërbime që na bëjnë unik jo vetëm për cilësinë e lartë të tyre, ndërtimit dhe infrastukturës mbështetëse, por edhe për përcjelljen e një "lifestyle" që klientët tanë meritojnë.

Nga hapat e parë të Green Coast deri më sot interesi i njerëzve për të shijuar natyrën e mrekullueshme, komoditetin dhe stilin e jetesës që ofron, ka ardhur vetëm në rritje. Për t'ju përgjigjur sa më mirë kësaj kërkese ne kemi diverstifikuar paketën e mundësive të zgjedhjeve, shtuar njësitë e biznesit me shërbime plotësuese, si dhe angazhuar staf me përvojë ndërkombëtare.

Të gjitha më sipër, kanë ndikuar pozitivisht në zgjatjen e sezonit veror dhe kohës mesatare të pushimeve për banorët dhe vizitorët e Green Coast nga 3.5 muaj që është periudha standarde në Shqipëri në 5 muaj.

Një ndër sfidat tona kryesore është që **Green Coast të garantojë një aktivitet të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit,** në mënyrë të balancuar, duke krijuar vlerë për banorët e vizitorët, aktual dhe të rinj, përmes investimeve, nismave dhe shërbimeve të reja që mund të ofrohen. Zhvillimi i Green Coast në drejtimet e përmendura automatikisht do ta vendoste Palasën, Shqipërinë në rrjetin turistik ndërkombëtar.

Jam shumë kurioze të shoh se çfarë mund të sjellë ky konkurs përmes kontributit tuaj me ide, dhe shpresoj se kjo sfidë do t'ju lejojë të aplikoni dhe zhvilloni aftësitë tuaja, si dhe të merrni disa mësime të vlefshme.

Përshëndetjet më të mira,

Ledia Telhai

RRETH
GREEN COAST

GREEN COAST
UNDISCOVERED GEM OF MEDITERRANEAN

Green Coast Resort and Residences është investimi më i madh i Grupit BALFIN në sektorin e turizmit, me vlerë mbi 120 milion Euro, pozicionuar në Palasë, një nga zonat më tërheqëse të Rivierës Shqiptare dhe Mesdheut.

Green Coast kombinon një shumëllojshmëri të vilave premium, një hotel ndërkombëtar me 5 yje, dhe një shëtitore 1 km përgjatë bregut, rrethuar nga njësi shërbimi e hapësira argëtuese. Në përbërje të projektit janë 516 vila, një pjesë e të cilave janë duke u ndërtuar në një sipërfaqe prej 160 hektarë.

SHËRBIMET PËR **REZIDENTËT & VIZITORËT**

Green Coast Resort and Residences mundëson një gamë të gjerë të shërbimeve për rezidentët dhe vizitorët me qëllim për të garantuar një cilësi të lartë jetese në komoditet.

Rezidentët dhe vizitorët e Green Coast kanë qasje të drejtpërdrejtë në të gjitha shërbimet dhe lehtësitë që ofron shëtitorja, në bashkëpunim me dhjetra njësi biznesi, si: recepsion dhe siguri (24/7), concierge, ATM, farmaci, bare, restorante, SPA, shërbim buggy dhe taksie, parking, etj.

Ndërsa, vetëm për rezidentët, Green Coast ofron gjithashtu edhe shërbime pastrimi, elektrike, hidraulike, gjelbërimi, dezifektimi, ajrosje njësie, transporti dhe ndërmjetësimi me furnitorë (oferta të dedikuara) për aredimin e shtëpisë.

Gjatë sezonit veror të këtij viti, shëtitorja dhe bizneset përreth kanë mikpritur 152 mijë vizitorë.



B4STUDENTS

www.b4students.com | hello@b4students.com

Informacioni i prezantuar në këtë material është përgjegjësi e programit B4Students. Materiali është përgatitur në funksion të Konkursit të Sfidave të Biznesit 2021 dhe nuk mund të përdoret si referencë dhe të publikohet nga palë të tjera, pa aprovim paraprak.